

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
 AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2008

SESIONI I

(I DETYRUAR)

VARIANTI A

E hënë, 9 qershor 2008

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja 5-vjeçare – seksioni dygjuhësh;

Shkolla e mesme me kohë të shkurtuar

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në prozë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rretho **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8a	8b	9	10	11	12
Pikët													
Kërkesa	13a	13b	13c	13d	14	15	16	17	18	19	20	21	22
Pikët													
Kërkesa	23a	23b	24a	24b	25								
Pikët													

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**Ndre Mjeda****Andrra e jetës**
(Fragment)**Lokja**

U shty vjeshta e krisantemi
Vetun vorreve lulzon;
Landët e pyje, gjith ku kemi,
Tuj fry veri po i cungon.

Ndrrojnë prej dimnit landa veshën,
E lëshon gjethët që para pat;
E, për mëshirë, duhitë që ndeshen
Ia çojn t'vorfnit ma i ba shtrat.

Bite borë e frynte veri
Tuj çue akull për gjithë vis;
Nalt orteku ushton për mneri
Tuj fundue çetinë e lis.

Me dy cokla n'votër plaka
Rri gjithë natën e vajton;
Rri me duer kah ndezet flaka
porsi nieri kur uron.

E shikon një dritë t'venitun;
Vron pasqyrën e jetës s'vet:
E larg Morden tuj kositun
E kujton e pran' e thrret.

U ndie'j frymë përbrenda shpijet
Porsi erë që vjen pa shkas
E n'at muzg, një vegim hijet
Lokes n'votër let' iu qas:

Përmbi plakën krahët i uli
E n'gryk t'shuemen e shtrëngoi;
Buzët t'shpulpueme n'ball ia nguli;
U ndal fryma e ajo mbaroi.

Fjalor:*Landët e pyje-* lëndët e pyjeve*Duhi* – erë e fortë*Mner* – tmerr*Tuj fundue* – duke fundosur*Uron* – lutet*frymë* – përfytyrimi i vdekjes si një frymë*pa shkas* – pa shkak*vegim hijet* - mortja*buzët e t'shpulpueme-* buzët që s'kanë mish

Për pyetjet 1-6 rretho **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Poeti në këtë pjesë priret të na tregojë:

1 pikë

- A) afrimin e një stine të ashpër dhe të ftohtë.
- B) braktisjen e një nëne nga të bijat.
- C) përfundimin e një jete të trishtë.
- D) kushtet e vështira në të cilat jetojnë fshatarët.

2. Brenga e Lokes është e madhe, sepse:

1 pikë

- A) ka frikë nga vdekja që po i afron.
- B) ndihet e vetmuar.
- C) nuk ka kryer si duhet detyrën.
- D) Zoga e ka zhgënjyer.

3. Detaji i krisantemës në strofën e parë, nënkupton:

1 pikë

- A) ardhmërinë e personazheve.
- B) se fati i njeriut është ndryshe nga ai i natyrës.
- C) parapërgatitje për afrimin e vdekjes.
- D) peizazhin e një dimri të ftohtë.

4. Përsëritja dy herë e foljes **rri** (strofa 4) tregon:

1 pikë

- A) përpjekje për t'u ngrohur.
- B) qetësi shpirtërore pas një lodhjeje të madhe.
- C) tronditje shpirtërore.
- D) vetmi të pangushëlluar.

5. Kjo këngë është shkruar me varg:

1 pikë

- A) 8 rrokësh.
- B) 9 rrokësh.
- C) 10 rrokësh.
- D) 11 rrokësh.

6. Ndikimi i Mjedës nga folklori duket në:

1 pikë

- A) përfytyrimin e vdekjes me kosë në dorë.
- B) përshkrimin e natyrës.
- C) përshkrimin e jetës në malësi.
- D) motivin e kohës që ikën.

7. Cila është gjendja në të cilën ndodhet Lokja? Ilustroje mendimin tënd me dy detaje nga fragmenti.

3 pikë

8. Gjej figurën bazë të stilistikës mbi të cilën ngrihen katër strofat e para dhe shpjego rolin e fuqishëm artistik që ajo luan.

2 pikë

a) figura: _____

b) shpjegimi: _____

9. Lexo vargun: “*Vron pasqyrën e jetës vet*”. Çfarë sheh ajo dhe si e motivon ky moment veprimin e saj të mëpasëm?

2 pikë

10. Cili është ritmi i këtij fragmenti? Shpjego arsyen e kësaj zgjedhjeje.

2 pikë

11. Interpretu përmes figurave të stilistikës (të paktën tre) imazhin që krijojnë dy strofat e fundit.

5 pikë

12. Si shfaqet Mjeda në këtë këngë: si realist apo si romantik? Pse?

1 pikë

- 13.** Lokja është konsideruar nga kritika si një figurë tragjike. A mendon se është e tillë? Argumento mendimin tënd në formën e një eseje.

8 pikë

Shtjellimi i idesë (13a)	Organizimi dhe struktura (13b)	Stili dhe originaliteti (13c)	Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) (13d)	Totali 13
2 pikë	2 pikë	2 pikë	2 pikë	8 pikë

PJESA II**Dostojevski****Krim e ndëshkim**

(Fragment)

Si atëherë, dera u hap fare pak dhe përsëri dy sy, si tehe brisku, dyshimtarë dhe përgjues, e panë në errësirë. Raskolnikovi mezi e përmbajti veten, për pak sa nuk bëri një gabim fatal.

Nga frika mos plaka nuk do të pranonte të ishte vetëm për vetëm me të dhe mos pamja do ta tradhtonte, u kap pas derës në atë mënyrë, që kjo të mos mundte ta mbyllte më. Pasi e njohu, plaka nuk u përpoq ta mbyllte me forcë derën, por pas dorezës u mbajt fort. E shty, plaka i hapi udhë e trembur. Bëri t'i thoshte diçka, por s'mundi, vetëm e pa me sy të shqyer.

- Tungjatjeta, Alena Ivanovna, - e përshëndeti sa më shpenguar, po zëri nuk iu bind: iu drodh dhe i ngeci në grykë. – Ju kam sjellë... diçka... Dalim pak këtu, në dritë... - E la aty ku ishte, kurse vetë hyri në dhomë pa pritur që ta ftonin. Plaka iu vu pas; edhe gjuha iu zgjidh, më në fund.

- O zot! Ç'bëni kështu? Ju kush jeni? Ç'doni nga unë?

- Më falni, Alena Ivanovna!... Po ju më njihni... Raskolnikov quhem. Ju solla pengun, ju kujtohet që ju fola? – zgjati sakaq pengun.

Plaka e pa, por vetëm shkarazi; i ngriti sytë, dhe pastaj e pa drejt në sy mysafirin e paftuar. E hetoi një hop me ligësi dhe me dyshim. Kaloi kështu si ndonjë minutë. Raskolnikovit iu duk që në sytë e saj rrëzëlliti përbuzja dhe tallja, si ta kishte kërkuar ç'kërkonte të bënte. E ndjeu që po hutohej, po lebetitej i tmerruar, dhe aq shumë, saqë po të vazhdonte ta shihte asisoj makar edhe ndonjë minutë, do ia therte vrapit.

- Si thua kështu? Nuk po më njihni? – nëpërdhëmbi thujse i zemëruar. – Do ta pranoni apo jo? Nëse nuk doni, shkoj te ndonjë tjetër, s'më pret puna!

Këtë ligjëratë nuk e kishte parapërgatitur, i doli ashtu, vetvetiu.

Plaka e mblodhi veten; zëri i sigurt i mysafirit, me sa dukej, i dha zemër.

- Ç'është kjo që thoni? Pa he, ç'paskeni sjellë? – tha dhe ia nguli shikimin pengut.

- Një kuti cigaresh prej argjendi. Ju fola për të herën që shkoj.

Plaka zgjati dorën.

- Po ç'keni kështu? Ju ka ikur fare fytyra!... Ja dhe duart ju dridhen! Mos erdhët pas banjës?

- Kam ethe,- iu përgjigj me zë të dridhur. – Nga ato dhe zbehtësia... Pastaj jam dhe pa ngrënë...- shtoi duke shqiptuar me vështirësi fjalët.

Përsëri po e linin forcat. Veç, përgjigja që i dha tingëlloi bindëse. Plaka e mori pengun.

- Kutit cigaresh... e argjendit... shiheni vetë.

- S'më duket si e argjendit kjo... E paske mbështjellë...

Në përpjekje për të zgjidhur spangon, u kthye nga drita (dritaret, me sa dukej, ishin të mbyllura, të merrej fryma nga ajri i ndenjtur) dhe gjatë disa sekondave qëndroi me shpinë nga djali. Raskolnikovi zbërtheu xhaketën, çliroi sëpatën nga laku, por nuk e nxori, vazhdoi ta mbante nën xhaketë me dorën e djathtë. Duart i qenë dobësuar fare, ndjeu t'i mpiheshin, po i bëheshin dru pas çdo çasti që kalonte. Kishte frikë mos nuk do të ishte në gjendje ta mbante fort më, mos i binte.

...Po i merreshin mendtë.

- E ç'e paske mbështjellë kështu?!- thirri plaka e nervozuar, duke lëvizur paksa në drejtim të tij.

Nuk duhej lënë të rrëshqiste çasti i volitshëm. Nxori sëpatën, e ngriti lart me të dyja duart dhe, duke mos qenë fare në vete, në një mënyrë krejt mekanike, e lëshoi mbi kokën e saj. Fuqitë iu prenë, por pas goditjes forcat i erdhën.

Plaka rrinte gjithmonë kokëjashtë. Flokët e verdhë, të thinjur, të lyer kurdoherë me vaj, i kishte thurur gërshet, dukeshin si dy bishta miu, dhe i kishte kapur me një krehër briri prapa zverkut. Sëpata e qëllloi në tëmtha, ngaqë ishte shtatvogël. Lëshoi një piskamë, fare të

dobët, dhe u përplas si e kositur në dysheme. Vetëm munda t'i ngrite dy duart dhe t'i vinte në kokë. Në njërën dorë vazhdonte të mbante pengun.

Ai u zbraps: e kishte parë si kishte rënë, si qe dridhur në grahmat e fundit, si kishte dhënë shpirt. Sytë i kishin kërcyer jashtë gropëzave, kurse balli dhe fytyra i qenë rrudhosur për lemeri dhe i qenë shtrembëruar nga ngërçi.

E la sëpatën në dysheme, pranë kufomës, dhe zuri të kërkojë në xhepat, duke u përpjekur të mos fëlliqej me gjak. E futi dorën në xhepin e djathtë, që andej i kishte nxjerrë çelësat radhën që shkoi. Mendja i punonte si sahat, asnjë errësim, asnjë marrje mendsh, vetëm duart i dridheshin si më parë. Më pas ndërmendi se kishte qenë edhe i kujdesshëm, përpiquej të mos zhyhej...I nxori çelësat, ishin si atëherë, të lidhur në një unazë metalike. Me ta në dorë, u turr për në dhomën e gjumit, ishte fare e vogël. I ra në sy dollapthi me xhamllëk plot me ikona. Pranë murit tjetër, qëndronte shtrati i madh, shumë i pastër, i mbuluar me kuvertë mëndafshi, poshtë të cilit ishte jorgani i pambuktë.

Për pyetjet 14-20 rretho vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

14. Qëllimi kryesor i këtij fragmenti është:

1 pikë

- A) të përshkruajë tensionin e një ngjarjeje.
- B) të komentojë rreth një krimi.
- C) të përshkruajë armiqësinë midis dy njerëzve.
- D) të dramatizojë një histori të vërtetë.

15. Ç'profesion ka Raskolnikovi?

1 pikë

- A) Aktor.
- B) Student.
- C) Tregtar.
- D) Nëpunës.

16. Gjatë gjithë këtij fragmenti Raskolnikovi sundohet nga:

1 pikë

- A) qetësia dhe siguria.
- B) ndjenja e frikës dhe pasigurisë.
- C) keqardhja dhe trishtimi.
- D) nervozizmi dhe revolta.

17. Në përshkrimin e plakës, autori përdor edhe shprehjen “*të lyer me vaj*”.

Kjo krijon ndjesinë e:

1 pikë

- A) ngrohtësisë dhe butësisë.
- B) zemërimit dhe inatit.
- C) neverisë dhe pështirosjes.
- D) tmerrit dhe ankthit.

18. Dy detajet më të forta në këtë fragment janë:

1 pikë

- A) dollapi dhe ikonat.
- B) kutia prej argjendi dhe mbështjellësja e saj.
- C) flokët e yndyrshme dhe ngjyra e tyre e verdhë.
- D) sëpata dhe gjaku.

19. Plaka e pret Raskolnikovin me dyshim dhe ligësi, sepse: **1 pikë**
- A) ka një armiqësi të vjetër familjare me të.
 B) është në natyrën e saj t'i presë njerëzit kështu.
 C) Raskolnikov i ka një borxh të pakthyer.
 D) ka frikë se Raskolnikov i ka kërcënuar.
20. Ç' veçori e stilit të Dostojevskit spikat në përshkrimin e skenës së krimit? **1 pikë**
- A) detajet e kursyera.
 B) përshkrim i detajuar i lëvizjeve.
 C) përdorimi i elementeve të absurdit.
 D) ndërthurja e reales me irrealen.
21. Cila është atmosfera që sundon në këtë fragment? Cili është funksioni artistik i saj? **3 pikë**
- _____
- _____
22. Në fragment bie në sy mungesa e përvojës së Raskolnikovit. Gjej dy momente, ku ai shfaqet i tillë. Ç'tregon kjo? **3 pikë**
- _____
- _____
- _____
23. Zbulo dy tipare *gjuhësore* që mbart dialogu që zhvillohet midis dy personazheve. Ç' gjendje psikologjike *të tyre* thekson kjo mënyrë dialogimi? **4 pikë**
- a) tiparet: 1. _____
2. _____
- b) gjendja psikologjike e personazheve: 1. _____
2. _____
24. Gjej mjetet e stilistikës bashkë me ilustrimet përkatëse (të paktën dy) me anën e të cilave është realizuar portreti i plakës në këtë fragment. Ç' efekt shkakton kjo mënyrë e përshkrimit të saj? **3 pikë**
- a) mjetet e stilistikës: _____
- _____
- b) efekti: _____
25. Në këtë fragment ka shumë shprehje frazeologjike të përdorura. Gjej një të tillë, e cila shpreh tensionin psikologjik të Raskolnikovit. **1 pikë**
- _____
- _____